

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Izraeli përgatit dosje kundër Erdogan në Hagë, në fokus trajtimi i kurdëve dhe financimi i Hamasit
ADRESA	https://newsbomb.al/bota/izraeli-pergatit-dosje-kunder-erdogan-ne-hage-ne-fokus-trajtimi-i-kurdeve-d-i402149
BURIMI	newsbomb.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	27 shtator 2026, 19:51:43 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	27 shtator 2026, 19:46:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	78d65dac6818650da0ebd1536528b5329c4556f6418032c301e4a43679bd9f6e
TEKSTI	059d8c63a2e1b7d4c375ec788b588bf4cf4cdf17fc21c274122d3bd5d38e7af1
PAMJA	a3862cb552481d8e3b451d232c8c7d95da907ada59b6c6f5a5da1e587f6f8d71

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	cc1ec86d6227f9bf2fddd693b182524857d2bf82ada2357b9a176c4896aa0483
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	3aac5177b059e894026952c5b076c374c5dd6b2fda5f20c0a9390b2c535810d8
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet, në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/cc1ec86d6227f9bf2fddd693b182524857d2bf82ada2357b9a176c4896aa0483>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

12 numrat e parë FALAS!
Version PDF

Abonohu te Revista

[Kreu](#) [Politikë](#) [Aktualitet](#) [Ekonomi](#) [Kulturë & Art](#) [Rajon](#) [Sport](#) [Bota](#) [Showbiz](#) [SocialBomb](#)

Çështjet kryesore

SPAK në gjurmët e shtetarëve të lidhur me Agasin

Haga vendos për katër ish-krerët e UÇK-së!

Arrestohet Ergys Agasi

Bota

27 Shtator 2026, 21:46

Izraeli përgatit dosje kundër Erdogan në Hagë, në fokus trajtimi i kurdëve dhe financimi i Hamasit



Shkruar nga Newsbomb



Netanyahu dhe Erdogan

Kryeministri izraelit Benjamin Netanyahu ka urdhëruar një grup ministrash dhe zyrtarësh të lartë që të nisin përgatitjet për një çështje të mundshme kundër presidentit turk Rexhep Tajip Erdogan në Gjykatën Ndërkombëtare Penale në Hagë.

Sipas agjencisë izraelite të lajmeve i24NEWS, nisma lidhet me akuzat për trajtimin e komunitetit kurd në Turqi dhe me pretendimet për financimin e Hamasit nga qeveria turke.

Vendimi për të përgatitur dosjen raportohet se erdhi pas përshkallëzimit të tensioneve mes Izraelit dhe Turqisë. Erdogan kishte njoftuar më herët se i kishte kërkuar Interpolit të lëshonte një "njoftim të kuq" për arrestimin e Netanyahut.

Sipas raportimit, çështja që po shqyrtohet nga pala izraelite do të përqendrohet kryesisht në politikën e qeverisë së Erdoganit ndaj pakicës kurde në Turqi, si dhe në pretendimet për mbështetje dhe financim të Hamasit.

Burimet e cituara nga i24NEWS bëjnë me dije se Izraeli po shqyrton mënyra të ndryshme për ta çuar përpara nismën ligjore. Një prej mundësive është referimi i çështjes në institucionet ndërkombëtare përmes një shteti të tretë.

Izraeli nuk është palë në Statutin e Romës, dokumenti themelues i Gjykatës Ndërkombëtare Penale, ndërsa as Turqia nuk e ka ratifikuar atë.

Revista



Abonohu tani dhe lexoje >

Lajmet e fundit



Aktualitet

Rrezikon të mbetet për gjithë jetën i paralizuar, i riu ka nevojë për ndihmën e shqiptarëve, familjarët me apel: Jemi të shkatërruar



Rajoni

Aleksandër Vuçiq jep dorëheqjen si president i Serbisë, ua lë "amanet" serbëve: Mos hiqni dorë kurrë nga Kosova!

Zbulo më shumë artikuj >

Përplasja diplomatike mes Izraelit dhe Turqisë

Përgatitja e një dosjeje të tillë shihet si pjesë e një serie zhvillimesh që kanë thelluar përplasjen mes Ankarasë dhe Tel Avivit, veçanërisht lidhur me luftën në Gaza dhe qëndrimin e Turqisë ndaj Hamasit.

Sipas burimeve të cituara nga i24NEWS, ekziston mundësia që iniciativa ligjore të përdoret edhe si instrument presioni politik dhe diplomatik ndaj presidentit turk.

Burimet pretendojnë se synimi mund të jetë parandalues dhe se autoritetet izraelite nuk dëshirojnë domosdoshmërisht që procesi të shkojë deri në fund, nëse përmes vetë ekzistencës së çështjes mund të ushtrohet presion ndaj Ankarasë.

Zyra e kryeministrit Benjamin Netanyahu nuk pranoi të komentojë raportimet mbi përgatitjen e çështjes. As zyrtarët e Ministrisë së Drejtësisë të Izraelit nuk kanë dhënë koment publik mbi këtë zhvillim. Për momentin, bëhet fjalë për përgatitje të raportuara të një çështjeje të mundshme, dhe jo për një proces gjyqësor të nisur zyrtarisht në Gjykatën Ndërkombëtare Penale.

Sondazh

Poll

Lexo gjithashtu



E Diel 19:22

Do të festonte 90-vjetorin nëse do të ishte gjallë, familja dhe Forza Italia përgatiten për homazhet dhe lamtumirën simbolike të Silvio Berlusconi (DETAJE)



Bota

Trump refuzon propozimin e Iranit për Hormuzin: Po e hedh poshtë marrëveshjen e tyre

E Shtunë 23:40



Bota

Stuhia e fuqishme godet verilindjen e SHBA-së, mijëra shtëpi pa energji dhe rrugë nën ujë

E Shtunë 23:10



E Shtunë 19:02 Newsbomb

Trump i jep botës “goditjen” e papritur, refuzon hapjen e Hormuzit, çmimi i naftës mund të shumëfishohet



Bota

Irani i ofron marrëveshje Amerikës për të rihapur Ngushticën e Hormuzit brenda shtatë ditësh, mediat: Trump e ka refuzuar!

E Shtunë 08:07



Bota

“Më mirë një grua pak tërheqëse, por besnike, sesa një simpatike me minifund”, deklarata e zëvendëskryeministrit Tajani ndez polemika në Itali

E Premte 09:19



E Enjte 21:45

Netanyahu i sfidon të gjithë dhe udhëton në Amerikë, delegatët braktisin fjalimin në OKB, kryeministri izraelit i quan akuzat për gjenocid “gënjeshtër”





Bota

10 vjet që nga hera e fundit që udhëheqësi kinez kaloi pragun e Shtëpisë së Bardhë, Xi Jinping viziton Amerikën

E Enjte 19:04



Bota

Lëshohet ALARMI: Moska synon të godasë vendet e Mesdheut, në shënjestër Italia (DETAJE)

E Enjte 07:47 Newsbomb



E Mërkurë 20:45

Rusia godet qendrat e të dhënave në Kiev, ndërpritet interneti për 100 mijë familje



Bota

Historia e pabesueshme e Rexhino Abazajt, 25-vjeçarit majtist që ka futur në konflikt 4 shtete: Itali, Hungari, Gjermani e Francë. Pse akuzohet shqiptari?

E Mërkurë 18:14



Bota

Fjalimi në Asamblenë e OKB-së, presidenti iranian akuza SHBA-së dhe Izraelit: Populli im ka qenë shënjestër e sulmeve frikacake

E Mërkurë 16:45



E Mërkurë 12:45

Elon Musk vlerëson Kinën për prodhimin e makinave elektrike: Cilësia është e

shkëqyer



Bota

Shërri në klubin e natës dhe celulari i hedhur në Danub “i hanë kokën” kryeministrit hungarez! Prokuroria kërkon heqjen e imunitetit të tij, në



Bota

Trump: SHBA dhe Irani zhvilluan takim 3-orësh në OKB, pritet marrëveshje

🕒 E Martë 23:37

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.